



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[24.01.2022]

Drejtuar: Operatorit ekonomik “KRIJON” shpk

Adresa: Tiranë Farkë Rr. e Elbasanit, nr. 57, Çollak, 1044.

Procedura e prokurimit/lotit: ”Procedurë e hapur e thjeshtuar”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës] **“Blerje pajisje për zjarrfikëset”. Nr. REF-16169-12-22-2021. Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës: 1 (një) muaj.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 187 datë 28 Dhjetor 2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “KRIJON” shpk NIPT K12023001A

Vlera pa tvsh 1.618.000 (një milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë.

Vlera me tvsh 1.914.600 (një milion e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind).

2.Operatori ekonomik “KLEDIA-06” shpk NIPT K47905866L

Vlera pa tvsh 1,480,000 (një milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Vlera me tvsh 1.776.000 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) leke.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

1 Operatori ekonomik “KLEDIA-06” shpk NIPT K47905866L

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 82 si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik nga të cilët rezultoi si më poshtë vijon:

1. Ak në rubrikën “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” në kriterin e përcaktuar në pikën 2.2.1 dhe në pikën 2.2.2 ka kërkuar shprehimisht si më poshtë vijon:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik “KLEDIA-06” shpk, nuk ka paraqitur në sistem, kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2018, 2019, 2020) pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në këtë mënyrë Autoriteti nuk krijon bindjen se operatori ekonomik sa më sipërcituar ka kapacitetin e duhur financiar për të realizuar me sukses kontratën.

2. Ak në kriteret e vecanta për kualifikim konkretisht në pikën 2.2.2 rubrika “kapaciteti ekonomik dhe financiar” ka kërkuar që:

” Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

Për sa më sipër, KVO gjatë shqyrtimit të ofertave konstatoi se operatori ekonomik “KLEDIA-06” shpk, nuk ka paraqitur në sistem, kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, por ka paraqitur vetëm dokumentin “Formular i Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin” i cili nuk është i barasvlefshëm me deklaratën e xhiros vjetore.

3. Ak në rubrikën “Kapaciteti teknik” në kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4, për këtë pikë është kërkuar shprehimisht si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/ broshurë dhe/ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi me qëllim përmbushjen e specifikimeve të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura dhe/ose skedat teknike, duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 5 të DST”.

Sa më sipër, KVO konstaton se operatori ekonomik “KLEDIA-06” shpk ka paraqitur katalogë nga Bauer Kompressoren në gjuhën angleze, të papërkthyer në gjuhën shqipe dhe të panoterizuar duke rënë ndesh me nenin 24 pika 2 të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku është përcaktuar se: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”. Gjithashtu është kërkuar markimi i artikujve të kërkuar për lehtësi identifikimi, por që nga ana e operatorit ekonomik nuk është plotësuar. Në këtë mënyrë OE sa më sipërcituar nuk ka përmbushur, kriterin, 2.3.4, të kapacitetit teknik, si pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit.

Ne nenin 80, pika 1 (a) të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet: “Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

“a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura”; Në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet: “3. **Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...**”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit fitues] Operatorit ekonomik “KRIJON” shpk. Adresa: Tiranë Farkë Rr. e Elbasanit, nr. 57, Çollak, 1044, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej Vlera pa tvsh 1.618.000 (një milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë. Vlera me tvsh 1.914.600 (një milion e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind) leke është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.